



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të propozimit të grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019, të dt. 12.11.2018, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2019, miratoi

PLANIN
VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

I.

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2019.

II.

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Komunës dhe pikat - temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III.

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

1. Muaji janar:

- Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit";
- Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A1, të lagjes "Dodona";
- Propozimrregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
- Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Bashkësisë Islame të Kosovës;
- Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, në Prishtinë;
- Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Hortkultura";

- Diskutim për Raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018;
- Diskutim për Raportin vjetor të punës së KKSb-së;
- Propozimvendimi për emërtimin e SHFMU "Shkolla e Gjelbër": Remzi Salihu, Shpend Canolli ose Sevasti Qiriazi;
- Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, në shfrytëzim SHPI-KFOR-it, "Film City", në Prishtinë.

2. Muaji shkurt:

- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2018 (TM4);
- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018;
- Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2019;
- Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë;
- Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës;
- Propozimrregullore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021;
- Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës B (Bahri Fazliu), pjesa jugore;
- Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit;
- Informatë për hartimin e Hartës zonale të komunës së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës;
- Informatë për procesin e Planit të mobilitetit.

3. Muaji mars:

- Raporti vjetor për çështje ekonomiko-financiare për vitin 2019;
- Raportet vjetore të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës;
- Bartja e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2018 në vitin 2019.
- Informatë për përgatitjen e korrje-shirjeve 2019.

- Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit.

4. Muaji prill:

- Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën janar - mars 2019;
- Propozimvendimi për formimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave të tjera nga ekzekutivi komunal;
- Rregullore për qentë endacakë dhe qentë e shtëpisë;
- Rregullore për parkingjet në qytet;
- Propozimrregullore për punën e komiteteve dhe Kuvendit.
- Propozimvendimi për miratimin e Planit të transparencës
- Propozimrregullore për ndryshimin e Rregullores për subvencione
- Propozimrregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive të tjera në komunën e Prishtinës;
- Vizitë studimore në Turqi

5. Muaji maj:

- Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për proces transparent të buxhetimit;
- Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore të MF-së;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për mbjelljet pranverore;
- Informatë për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
- Propozimrregullore për leje të punës;
- Informatë për ndarjen e bursave për studentë.

6. Muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2019;

- Seancë solemne “11 Qershori - Dita e Çlirimit të Prishtinës”;
- Miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore 2020-2022;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave të tjera nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve në komunë;
- Rregullore për ushtrimin e veprimtarisë “Auto Taxi”.
- Seancë për promovimin e të drejtave të fëmijëve.

7. Muaji korrik:

- Raport i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019;
- Shqyrtimi i Informatës financiare të Komunës për periudhën prill – qershor 2019;
- Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Prishtinës për vitin 2018;
- Informatë për Qarkoren e dytë buxhetore të brendshme komunale;
- Informatë për performancën e Komunës, MAPL;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për Planin e mobilitetit;
- Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të vitit shkollor 2018/2019, testit të arritshmërisë dhe testit të maturës.
- Informatë për infrastrukturën sportive në komunën e Prishtinës.

8. Muaji gusht:

Pushim

9. Muaji shtator:

- Informatë për mbarimin e vitit shkollor 2018-2019 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020;
- Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për vitin 2020;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale.
- Informatë për Hartën zonale të komunës së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës

10. Muaji tetor:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën korrik - shtator 2019;
- Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë mbi zbatimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
- Informatë nga drejtoria për të mbjellat vjeshtore.
- Informatë për muajin e Rinisë

11. Muaji nëntor

- Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin dimëror;
- Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi;
- Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF etj.)
- Seancë solemne me rastin e festës së 28 nëntorit.

12. Muaji dhjetor

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020;
- Shqyrtimi i raportit (informatës) për aktivitetet e KKS-së;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për punën e Njësisë së auditimit të brendshëm;
- Informatë për punën e Komitetit të auditimit;
- Informatë për punën e komiteteve të tjera.
- Propozimvendimi për miratimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2020.

IV.

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

V.

Ky plan hyn në fuqi 15 ditë nga dita e protokollimit në Njësinë për administrimin e dokumenteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0049024/19, më 01.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale dhe Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL - së, Kuvendi i Komunës nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2018, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozimplanit të Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

Grupi punues ka mbajtur takim më 15.02.2019 dhe pas finalizimit të këtij propozimplani, i njëjti i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tij.